



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 33

Tiranë – E hënë, 25 shtator 2023

PËRMBAJTJA

		Faqe
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 555, datë 19.9.2023	Për caktimin e ditës, orës, vendit të zhvillimit të provimit të kualifikimit për ndërmjetës, afatit të paraqitjes së kërkesave për shprehje interesi për të hyrë në provim dhe dokumenteve përkatëse që duhet të shoqërojnë kërkesën.....	3
Kërkesë e Ministrisë së Drejtësisë nr. 5565/1, datë 22.9.2023	Për shprehje interesi për kandidatët që kërkojnë të certifikohen si ndërmjetës të pasurive të paluajtshme.....	3



URDHËR

Nr. 555, datë 19.9.2023

**PËR CAKTIMIN E DITËS, ORËS, VENDIT
TË ZHVILLIMIT TË PROVIMIT TË
KUALIFIKIMIT PËR NDËRMJETËS,
AFATIT TË PARAQITJES SË KËRKESAVE
PËR SHPREHJE INTERESI PËR TË
HYRË NË PROVIM DHE
DOKUMENTEVE PËRKATËSE QË
DUHET TË SHOQËROJNË KËRKESËN**

Në mbështetje të neneve 6 dhe 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar; të pikës 1, të nenit 5, të ligjit nr. 10385/2011, “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, të ndryshuar; të pikës 4 të urdhrit nr. 90, datë 23.2.2021, të ministrit të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores së Provimit të Kualifikimit për Profesionin e Ndërmjetësit”,

URDHËROJ:

1. Caktimin e datës 10.11.2023, ora 16:00, për zhvillimin e provimit të kualifikimit për ndërmjetës, në Sallën e Konferencave të Ministrisë së Drejtësisë.

2. Paraqitjen e kërkesave për shprehjen e interesit për të hyrë në provimin e kualifikimit për ndërmjetës, jo më vonë se 21 ditë përpara ditës së organizimit të provimit, të caktuar në pikën 1 të këtij urdhri.

3. Çdo kërkesë për shprehjen e interesit si më sipër duhet të shoqërohet nga dokumentacioni si vijon:

a) kopje e dokumentit të identifikimit (pasaportë apo letërnjoftim ID);

b) jetëshkrim;

c) vërtetim i gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti);

ç) diplomë e noterizuar për përfundimin e studimeve të ciklit të dytë dhe listën e notave, sipas përcaktimeve të legjislacionit për arsimin e lartë;

d) kopje të certifikatës së përfundimit të programit të trajnimit fillestar;

dh) kopje të noterizuar të librezës së punës ose vërtetim nga punëdhënësi, ku të vërtetohet eksperiencia profesionale jo më pak se tre vjet.

4. Ngarkimin e Drejtorisë së Përgjithshme Rregullore të Çështjeve të Drejtësisë dhe Dhomës

Kombëtare të Ndërmjetësve për marrjen e masave për zbatimin e këtij urdhri.

5. Publikimin e këtij urdhri në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Dhomës Kombëtare të ndërmjetësve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

KËRKESË

Nr. 5565/1, datë 22.9.2023

**PËR SHPREHJE INTERESI PËR
KANDIDATËT QË KËRKOJNË TË
CERTIFIKOHEN SI NDËRMJETËS TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME**

Në ligjin nr. 9/2022, “Për profesionin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme”, dhe në urdhrin nr. 187, datë 4.5.2022, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme mbi paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe në verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore të personave që kërkojnë të certifikohen si ndërmjetës të pasurive të paluajtshme”, janë përcaktuar rregullat për paraqitjen, trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore të personave që kërkojnë të certifikohen si ndërmjetës të pasurive të paluajtshme.

Kandidati për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme paraqet shprehjen e interesit dhe të dokumentacionin shoqërues, brenda 15 ditëve nga përfundimi i afatit të publikimit.

Kandidati për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme, që kërkon të certifikohet si ndërmjetës i pasurive të paluajtshme, depoziton pranë Ministrisë së Drejtësisë, përmes shërbimit postar ose dorazi, dokumentacionin bashkëngjitur:

1. Kërkesë për shprehje interesi për certifikimin si ndërmjetës i pasurive të paluajtshme;

2. Kopje të mjetit të identifikimit;

3. Certifikatë familjare;

4. Kopje të njësuar të diplomës së arsimit të mesëm të lartë, të lëshuar nga një institucion arsimor i akredituar në Republikën e Shqipërisë ose diplomë të lëshuar nga një institucion arsimor i huaj, të njohur e të njësuar nga ministria përgjegjëse për arsimin;



5. Vërtetim nga prokuroria që nuk është nën hetim për veprat penale në fushën e pastrimit të parave, të financimit të terrorizmit apo të armëve të shkatërrimit në masë;

6. Vërtetim nga gjykata që nuk është nën gjykim për veprat penale në fushën e pastrimit të parave, të financimit të terrorizmit apo të armëve të shkatërrimit në masë;

7. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore të kandidatit dhe për personat e lidhur me të;

8. Vetëdeklarim që nuk ka dënim me masë administrative gjorbë ose masë administrative, që detyron subjektin të ndalë një sjellje të caktuar, praktikë pune apo biznesi, si dhe të mos e përsëritë në të ardhmen, për shkelje të legjislacionit në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave, të paktën jo më herët se 6 muaj nga data e paraqitjes së kërkesës;

9. Certifikatë për përfundimin me sukses të programit të detyrueshëm të trajnimit për kandidatët

për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme (*me urdhrin e ministrit të Drejtësisë nr. 619, datë 23.11.2022, "Për përzgjedhjen e institucioneve trajnuese për realizimin e programit të detyrueshëm të trajnimit për kandidatët për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme", të ndryshuar me urdhrin nr. 162, datë 9.2.2023, "Për një shfuqizim në urdhrin nr. 619, datë 23.11.2022, të ministrit të Drejtësisë, Për përzgjedhjen e institucioneve trajnuese për realizimin e programit të detyrueshëm të trajnimit për kandidatët për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme", ka vendosur se institucioni, i cili do të zhvillojë trajnimin e detyrueshëm për kandidatët për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme, është KUB-i (Kolegji Universitar i Biznesit);*

10. Dokument që provon zotërimin e gjuhës shqipe, të lëshuar nga autoritetet kompetente, sipas legjislacionit në fuqi (për shtetasin e huaj).

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Tiranë, 2023